



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER RIDVANA G. RUÇI  
ADRESA KAJO KARAFILI  
TEL: 683030361**

# **VERTETIM NENSHKRIMI**

**(AKT THEMELIMI)**

**Nr. repertori: 2283**

**Tirane më 22/04/2022**

**Ligjet referuese:**

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"




V2022053240127029806

REPUBLICA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER RIDVANA G. RUÇI



V2022063240133029806



**VERTETIM STATUT dhe AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"MTB" SH.P.K**

Sot më datë 22/04/2022 une noterja Ridvana Ruci., me Zyre ne rrugen "Kajo Karafili", deklaroj se para meje u paraqiten personalisht personat e meposhtem te cilet me kerkuan hartimin dhe nenshkrimin e ketij Statuti dhe Akti Themelimi te nenshkruarit

Klajdi Dakaj, atësia Ndue, amësia Nafie, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë H.H.Dalliu Nr.16; Nd. ; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 0000; Tiranë, lindur më 14/09/1995, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032740527 dhe nr. personal J50914064B.

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noteres, "Akti Themelimi dhe Statutin, bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Notarinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

RIDVANA G. RUÇI



V2022053240127029806



**AKT THEMELIMI**  
**&**  
**STATUT I SHOQËRISË TREGTARE TË SË DREJTËS SHQIPTARE**  
**« MTB » Sh.P.K.**

Sot, me date 22/04/2022 ne cilesine e ortakut te shoqerise **MTB shpk** une nenshkruesi i meposhtem bie dakort per hartimin dhe nenshkrimin e ketij Statuti dhe Akti Themelimi një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K)

Klajdi Dakaj, atësia Ndue, amësia Nafie, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë H.H.Dalliu Nr.16; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 0000; Tiranë, lindur më 14/09/1995, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032740527 dhe nr. personal J50914064B.

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, te ndryshuar, dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, kam miratuar kete Statut si vijon:

## **KAPITULLI I**

### **THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA - OBJEKTI – KOHEZGJATJA**

#### **Neni 1**

##### **Themelimi, Emri dhe Forma**

Emri dhe emertimi tregtar i Shoqerise eshte **MTB SH.P.K.**

Shoqeria **MTB shpk.** eshte nje person juridik privat, e themeluar ne baze te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” (me pas referuar si “Ligji Tregtar”) ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar (Sh.P.K.).

Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare te Biznesit (me pas referuar si “QKB”) ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqeria behet pergjegjese kundrejt paleve te treta, per detyrimet dhe demet qe shkakton gjate veprimtarise se saj.

Ortaket e Shoqerise do te jene pergjegjies kundrejt paleve te treta deri ne shumen e kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

#### **Neni 2**

##### **Selia**

Shoqeria do ta kete seline e saj ne adresen e meposhtme : Rr. Komuna e Parisit, Tirane , Hyrja 3. Pasuria me nr 6/759+3-n1, ZK 8260, Vol 61, Faqe 184, lloji "Njesi", Njesia Bashkiake nr. 5.

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi kudo brenda Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 3**

##### **Objekti**

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë sa vijon:



V2022053240127029806

Ideimi, realizimi, promovimi dhe tregtimi i shërbimeve nepermjet telefonit, shtypit elektronik dhe te shkruar dhe terminaleve te kompjuterave; ideimin, realizimi, promovimin dhe operimin e shërbimeve informtaike tele-audioj (Audiotex). Ofrimi i shërbimeve te trainimit dhe konsultimit ne ceshjet e telekomunikacionit. Ofrimi, mbeshtetja dhe operimi i shërbimeve te internetit etj.. Shërbime telefonike, Call Center, kryerjen e shërbimeve te shitjes se produktit me ane video call, telefonatave dhe me ane te telemarketing si dhe hapje zyresh teleperformance etj.Import-eksport si dhe çdo aktivitet tjetër qe lidhet me objektin e mesiperem, kryerje e shërbimeve perkatese ne lidhje me to. Te operoje ne sektorin e telekomunikacionit duke kryer cdo lloj veprimtarie nepermjet telefonit per llogari te vet apo te treteve me seli ne Shqiperi apo ne cdo vend tjetër qe ka lidhje me Republiken e Shqiperise,duke respektuar ligjin ne fuqi,te kryeje aktivitete nepermjet telefonit te cdo lloji per llogari te vet apo te treteve, telemarketing, sekretari telefonike, shitje nepermjet telefonit,sondazhe promocionale dhe cdo lloj tjetër aktiviteti te lidhur me te,ku persa permendur me siper nuk mund te jete saktesisht apo e kufizuar,te bleje e te shese ose te jape me qera,ne perdorim,ne uzufukt ose ne shfrytezim pasuri te luajtshme e pasuri te paluajtshme te rregjistruara ne rregjistrat publike,shoqeria mund te kryeje gjithashtu te gjitha operacionet tregtare,mbi pasauri te luajtshme apo te paluajtshme,qe do te vleresohen te nevojshme apo te dobishme per realizimin e objektit te shoqerise si dhe te bleje pjesemarrje ne kapitalin themeltar te shoqerive te tjera qe kane objekt te ngjashem apo te afert me te vetin,shoqeria mund te kete pjesemarrje ne formen e mbajtjes se aksioneve/kuotave apo interesave te tejera ne shoqeri tregtare apo ndermarrje me objekt veprimtari te cfaredo lloji,ashtu sikurse do te ofroje dhe jane garanci te gjitha formave ligjore per sigurimin e permbushjes se detyrimeve te te treteve,gjithashtu mund te kryeje te gjitha veprimet e 2 nevojshme te vendimmartjes dhe adminstrimit te shoqerive apo ndermarjeve ne te cilat merr pjese ne cilesine e ortakut apo aksionerit si dhe do te kryeje cdo veprimtari tjetër tenatyres financiare e tregtare per permbushjen e objektit te veprimtarise,ne perputhje me ligjin Shqipetar,objekti I shoqerise mund te ndryshohet ,shtohet apo kufizohet ne baze te vendimit te asamblese

Sidoqoftë, asgjë nuk do të interpretohet këtu si kufizim i mundësisë së shoqërisë për të hyrë në tregje apo aktivitete dhe operacione të tjera tregtare që janë të lidhura me apo në funksion të objektit të mësipërm.

Objekti i aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim te Asamblese ne Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe kete Statut

Sidoqoftë, asgjë nuk do të interpretohet këtu si kufizim i mundësisë së shoqërisë për të hyrë në tregje apo aktivitete dhe operacione të tjera tregtare që janë të lidhura me apo në funksion të objektit të mësipërm.

Objekti i aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe kete Statut.

#### **Neni 4 Kohezgjatja**

Kohezgjatja e Shoqerise eshte e pakufizuar. Shoqeria mund te priset ne cdo kohe me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

## **KAPITULLI II KAPITALI – KUOTAT**

#### **Neni 5 Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100,000 Lekë (nje qind mije leke).



V2022053240127029806

Kapitali themeltar perbehet nga 1 (nje) kuote qe eshte paguar e zoterohen teresisht nga ortaku themelues si vijon:

Klajdi Dakaj zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë nominale 100,000 Lekë, duke përfaqësuar 100% (njqind perqind) të kapitalit themeltar.

Ortaku eshte pergjegjes kundrejt paleve te treta per humbjet qe peson Shoqeria, deri ne shumen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.

Fitimi qe do te rezultoj nga veprimtari e shoqerise i takon ortakut te saj. Shoqeria nuk pergjigjet per humbjen e ortakeve te saj jashte veprimtarise se shoqerise. Mosmarrevshjet qe mund te lindin mes paleve brenda dhe jashte shoqerise, me persona fizike e juridike zgjidhen nga Gjykatat kompetente Shqiptare.

## **Neni 6**

### **Kuotat**

#### **Te drejtat dhe detyrimet e lidhura**

Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratoreve ("Regjistri i Ortakeve").

Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vlerën e kuotes qe zoterohet nga cdo Ortak; (iii) daten e fitimit te pronesise se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

## **Neni 7**

### **Transferimi i Kuotave**

1. Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje ne cdo forme te gjithe apo nje pjese te kuotes se tij nje personi te ndryshem nga Ortaket, secili prej Ortakeve te tjere ka te drejten e parablerjes mbi te gjithe apo nje pjese te kuotes ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar, ne varesi te faktit se sa ortake do te ushtrojne te drejten e parablerjes ne rastin konkret. E drejta e parablerjes ushtrohet vetem ne perputhje me proceduren ne vijim.
2. Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje te gjithe apo nje pjese te kuotes se tij, ai, perpara se te nenshkruaje marrevshje me persona te ndryshem nga Ortaket, do te njoftoje me shkrim Administratoret per transferimin e planifikuar, duke percaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at te cileve planifikon t'u transferoje kuoten dhe kushtet esenciale qe do te aplikohen per transferimin.
3. Administratoret, brenda 10 diteve duke filluar nga dita kur eshte njoftuar nga Ortaku per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te informojne me shkrim Ortaket e tjere.
4. Secili prej Ortakeve qe ka te drejta parablerjeje, brenda 1 (nje) muaji nga njoftimi prej Administratoreve per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te njoftoje me shkrim Administratoret nese ka qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes.
5. Administratoret brenda 10 diteve nga marrja e ketij njoftimi do te njoftojne me shkrim Ortakun qe deshiron te transferoje kuotat e tij.
6. Nese me shume se nje Ortake ushtrojne te drejtat e parablerjes se kuotes, ata do te blejne kuoten ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar.



V2022053240127029806

7. Nëse asnjë njoftim nuk është dhënë nga ndonjë Ortak si me sipër, Ortaku që ka për qëllim të transferojë kuotën e tij do të jetë i lire të transferojë këtë kuota personit/ave të përcaktuar prej tij.
8. Nëse vetëm një Ortak ka dhënë njoftim për qëllimin e tij për të ushtruar të drejtën e parablerjes, ky Ortak do të ketë të drejtë të blejë kuotën objekt transferimi brenda 10 ditëve nga data e mbarimit të afatit 1 (një) mujor të përcaktuar me sipër.
9. Çdo transferim i kuotave që nuk kryhet në përputhje me parashikimet e këtij neni është i pavlefshëm dhe pa efektë për Shoqerine.
10. Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie apo brenda familjes

#### **Neni 8**

##### **Zmadhimi i Kapitalit**

Kapitali themeltar mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, nëpërmjet emetimit të kuotave të reja ose rritjes së vlerës nominale të atyre ekzistuese ose në çdo formë tjetër të parashikuar nga Ligji. Për çdo zmadhim kapitali të Shoqerisë nëpërmjet emetimit të kuotave të reja, Ortaket do të kenë të drejtën e parablerjes për nënshkrimin e këtyre kuotave të reja të emetuara. Nëse me shumë se 1 (një) Ortak ushtrojnë të drejtat e tyre të parablerjes brenda 20 (njëzet) ditëve, atëherë ata do t'i blejnë këto kuota në përpjestim me pjesëmarrjen e tyre aktuale në kapitalin themeltar. Çdo kuota e re që nuk është blerë nga Ortaket gjatë këtij procesi, i ofrohet çdo palë të tretë.

Kuotat e reja që do të shlyhen si me para në dorë, ashtu edhe në natyrë, do të paguheshin në përputhje me Vendimin përkatës për zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin për Shoqeritë Tregtare.

#### **Neni 9**

##### **Zvogelimi i Kapitalit**

Kapitali mund të zvogelohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, në përputhje me Ligjin për Shoqeritë Tregtare.

### **KAPITULLI III**

#### **ORGANET E SHOQERISE**

#### **Neni 10**

##### **Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve**

Asambleja e Përgjithshme do të jetë organi më i lartë i Shoqerisë, i cili, veç kompetencave të tjera sipas Ligjit për Shoqeritë Tregtare apo këtij Statuti, merr vendime për çështjet e mëposhtme të Shoqerisë:

- a. përcaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime të Statutit;
- c. emerimi i Administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i ekspertëve kontabel të autorizuar;
- e. miratimi i skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c. dhe d.;
- f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqerisë;
- g. shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- i. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar të Shoqerisë;
- j. pjesëtimin dhe anulimin e kuotave;
- k. përfaqesimin e shoqerisë në gjykime;
- l. riorganizimin dhe prishjen e Shoqerisë;
- m. miratimin e rregullave të zbatueshme procedurale të mbledhjeve të saj;
- n. çështje të tjera sipas parashikimeve të bera prej këtij Statuti.





V2022053240127029806

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme mund të dërgohet me shkrim apo e-mail në adresat që secili Ortak do t'i njoftojë me shkrim Shoqërisë me postë të regjistruar. Njoftimi do të konsiderohet se i është dorëzuar Shoqërisë me kalimin e ditës së 10-të pas dërgimit.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë duhet të përcaktojë qartë emrin e Shoqërisë, selinë, datën, kohën dhe vendin e mbledhjes, një përshkrim të hollësishëm të procedurës që duhet të ndiqet nga Ortaket për pjesëmarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyrën e marrjes së dokumenteve dhe projekt-vendimeve që duhet të vihen në dispozicion të gjithë Ortakëve, po ashtu edhe rendin e ditës, dhe duhet t'u njoftohet Ortakëve të paktën 14 (katërmbëdhjetë) ditë para mbledhjes. Rendi i ditës i njoftuar si më sipër duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të vendosë për ndryshime të Statutit, teksti përkatës duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve do të thirret nga Administratoret dhe, kur është e zbatueshme, nga Ortaket.

Një Ortak mund të përfaqësohet në Asambelën e Përgjithshme të Ortakëve nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë i ndryshëm nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin përkatës autorizues. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures se veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve që përcaktojnë detyrime shtese ose kufizojnë / zvogelojnë të drejtat që u janë njohur ortakëve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtezohet nga miratimi i Ortakut të interesuar / përkatës.

Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratoret janë përgjegjës për mbajtjen e një kopjeje të tij.

**Neni 11**

**Organi Administrues / Administratoret**



V2022053240127029806

Organi Administrues perbehet nga E (nje) Administrator qe emerohet e shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte 5 (pese) vjet, me te drejte ri-emerimi.

Personi i mëposhtëm caktohen si Administrator i parë i shoqërisë me mandat 5 vjeçar:

**Klajdi Dakaj, atësia Ndue, amësia Nafie, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë H.H.Dalliu Nr.16; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 0000; Tiranë, lindur më 14/09/1995, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032740527 dhe nr. personal J50914064B.**

Administratori perfaqeson Shoqerine sipas parashikimeve te Statutit.

Administratori do te:

(i) administroje veprimtarine tregtare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve;

(ii) perfaqesoje Shoqerine;

(iii) kujdeset per mbajtjen e rregullt te librave dhe dokumenteve kontabel;

(iv) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, te cilat ia paraqet Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratim, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;

(v) krijoje nje sistem njoftimi te pershtatshem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;

(vi) kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit Tregtar apo te ligjeve te tjera te zbatueshme;

(vii) raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe per perfundimin e transakcioneve me rendesi te veçante per performancen e Shoqerise;

(viii) kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne kete Statut;

(ix) therrase mbledhjen e Asamblese se Ortakeve sa here qe kerkohet sipas Ligjit apo ketij Statuti.

Administratori mund te autorizojë persona te tjere per te vepruar ne emri dhe per llogarine e tij, duke specifikuar / percaktuar kategorine e akteve dhe veprimeve qe perfaqesuesi mund te kryeje.

Veç kufizimeve ligjore, nuk vendosen kufizime te kompetencave te administrimit.

## **Neni 12**

### **Kontrolli i Shoqerise**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te emeroje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per kontrollin e llogarive te Shoqerise.

## **KAPITULLI IV**

### **VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE**

## **Neni 13**

### **Viti Financiar**

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhete) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Ne menyre perjashtimore, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

## **Neni 14**

### **Rezerva Ligjore**

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezerve te detyrueshem te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve te arrije vleren e barabarte me 10% (dhjete per qind) te kapitalit themeltar.





V2022053240127029806

#### **Neni 15**

##### **Dividendet**

Pas miratimi të bilancit vletor dhe percaktimit të shumës që do të ndahet, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumën e fitimeve që do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend, në përjestim me pjesën perkatese në kapitalin themeltar.

Fitimi i deklaruar në pasqyrat financiare mund të shperndahet vetëm nëse shoqëria ka likuiditet të mjaftueshëm që garanton shlyerjen e detyrimeve.

#### **KAPITULLI V**

#### **PRISHJA - LIKUIDIMI**

#### **Neni 16**

##### **Prishja e Shoqërisë**

Shoqëria priset (i) me vendim të Asamblese së Pergjithshme të Ortakeve; ose (ii) në rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqëria nuk ka kryer veprimtari për 2 (dy) vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKB; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) për arsye të tjera të parashikuara në ligj.

#### **Neni 17**

##### **Likuidimi**

Me përjashtim të rastit të fillimit të një procedure falimentimi, prishja e Shoqërisë shoqërohet me fillimin e procedureve të likuidimit.

#### **Neni 18**

##### **Dispozita Perfundimtare**

Për të gjitha ceshtjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar.


Konfliktet në lidhje me këtë Statut do të zgjidhen nga gjykata e rrethit gjyqësor në territorin e së cilës Shoqëria ka selinë e saj.

Me qëllim shmangjen e çdo paqartësie, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose çdo funksionari tjetër nuk do të konsiderohen si ndryshime të këtij Statuti.

Për ndjekjen e të gjithë procedurave në lidhje me regjistrimin fillestar të Shoqërisë dhe akteve përkatëse në Regjistrin Tregtar (QKB) në autorizojmë nepermjet këtij akti **Z. Klajdi Dakaj, atësia Ndue, amësia Nafie, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë H.H.Dalliu Nr.16; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 0000; Tiranë, lindur më 14/09/1995, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032740527 dhe nr. personal J50914064B, i cili mund të paraqitet e veprjë me të drejta e kompetenca të plota për nënshkrimin dhe dorëzimin e çdo aplikimi, kërkesë dhe/ose dokumenti që konsiderohet se duhet paraqitur pranë Regjistrin Tregtar për kompletimin e regjistrimit.**

Ky Statut nënshkruhet rregullisht në 3 (tre) origjinale në gjuhën Shqipe.

#### **ORTAKU THEMELEUES**

1.  .....